

V E N D I M
Nr.15, datë 12.1.2001

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.60, DATË 27.2.1992, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR TRAJTIMIN ME PAGË DHE SHTESA MBI PAGË TË
USHTARAKËVE”, NË VENDIMIN NR.54, DATË 27.2.1992, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR SISTEMIN E PAGAVE TË MINISTRISË SË RENDIT PUBLIK DHE
USHTARAKËVE TË MINISTRISË SË DREJTËSISË” DHE NË VENDIMIN NR.726, DATË
21.12.2000, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PAGAT E PUNONJËSVE TË
INSTITUCIONEVE BUXHETORE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999, “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, dhe të ligjit nr.8718, datë 19.12.2000, “Për buxhetin e shtetit të vitit 2001”, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Punës dhe Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I :

I. Të rriten pagat e ushtarakëve, të sistemit të Ministrisë së Mbrojtjes dhe të Ministrisë së Rendit Publik, në masën 10 për qind.

II. Në vendimin nr.60, datë 27.2.1992, të Këshillit të Ministrave, “Për trajtimin me pagë dhe shtesat mbi pagë të ushtarakëve”, bëhen këto ndryshime:

a) Në pikën 1, niveli më i ulët i pagës së ushtarakut aktiv të jetë 7720 lekë në muaj, kurse niveli më i lartë (drejtor drejtorie) të jetë 32 670 lekë në muaj.

b) Në pikën 2, paga e ushtarakut të shërbimit aktiv, e nxënësve dhe e studentëve ushtarakë të jetë deri 930 lekë në muaj.

c) Në pikën 5, paragrafi i tretë, paga për ushtarin rezervist të jetë dEri 666 lekë në ditë.

Ç) Paga mujore për funksionet e mëposhtme të bëhet:

- Shef i Shtabit të Përgjithshëm 77 865 lekë

- Zëvendësshefi i Shtabit të Përgjithshëm 61 090 lekë

- Drejtor i përgjithshëm 63 355 lekë

- Shef i kabinetit të ministrit (ushtarak) 59 630 lekë

- Këshilltar i ministrit (ushtarak) 50 180 lekë

III. Në vendimin nr.54, datë 27.2.1992, të Këshillit të Ministrave, “Për sistemin e pagave të Ministrisë së Rendit Publik, dhe ushtarakëve të Ministrisë së Drejtësisë”, bëhen këto ndryshime:

a) Në pikën 1, niveli më i ulët i pagës bazë të ushtarakut të sistemit të Ministrisë së Rendit Publik, të jetë 7 720 lekë në muaj dhe niveli më i lartë (drejtor drejtorie) të jetë 33614 lekë në muaj, ndërsa niveli më i ulët dhe më i lartë për ushtarakun e sistemit të Ministrisë së Drejtësisë të mbetet i pandryshuar, përkatësisht 7 018 lekë në muaj dhe 30 558 lekë në muaj.

b) Në pikën, paga e ushtarëve të shërbimit të detyrueshëm dhe e studentëve të shkollave të Ministrisë së Rendit Publik të jetë deri në 930 lekë në muaj.

c) Për ushtarakët e Ministrisë së Rendit Publik, paga e të cilëve është përcaktuar me vendime të veçanta të Këshillit të Ministrave (jashtë sistemit të pagave me klasa) pagat rriten me 10 për qind.

ç) Paga mujore për funksionet e mëposhtme bëhet:

- Drejtor i përgjithshëm i Policisë 73 870 lekë

- Zëvendësdrejtor i përgjithshëm i Policisë 66 890 lekë

- Komandant i Gardës së Republikës 66 890 lekë

IV. Në vendimin nr.726, datë 21.12.2000, të Këshillit të Ministrave, “Për pagat e punonjësve të institucioneve buxhetore”, paragrafi i parë, pika 20 ndryshohet si vijon:

“Për natyrë të veçantë pune, punonjësit civilë në sistemin e Ministrisë së Mbrojtjes përfitojnë shtesë mbi pagën bazë mujore në masën deri në 32 për qind, ndërsa punonjësit civilë në sistemin e Ministrisë së Rendit Publik në masën deri në 65 për qind.”.

V. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i miratuar për vitin 2001, për secilën ministri.

VI. Ngarkohen Ministria e Financave, Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale, Ministria e

Mbrojtjes dhe Departamenti i Administratës Publike, që brenda datës 28.2.2001, të paraqesin në Këshillin e Ministrave, për shqyrtim e miratim, studimin përkatës për përmirësimin e sistemit të pagave të ushtrarakëve të Ministrisë së Mbrojtjes.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 1 janar 2001.

KRYEMINISTRI

Ilir Meta